



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.9/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtares M.B, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga K.K “SH.K” në Pejë përmes D.F.S, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 17.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga K.K “SH.K” në Pejë përmes D.F.S, ndaj gjyqtares M.B, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 22.09.2022, K.K “SH.K” në Pejë përmes D.F.S, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtares M.B me arsyetimin se K.K në Pejë në vitin 2018, në Gjykatën Themelore në Pejë ka paraqitur padi për lirim të patundshmërisë dhe ky proces është udhëhequr me numër C.nr.968/18, ku gjyqtare e çështjes ka qenë gjyqtarja M.B, e cila me datë 03.02.2021, ka marrë Aktvendim me të cilin ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses K.K “SH.K” në Pejë kundër të paditurës Komuna e Pejës për kthim të paluajtshmërisë mirëpo, këtë vendim nuk ja ka dërguar paditëses dhe komplet lëndën e dërgon në arkivin e gjykatës. Lidhur me këtë, parashtruesi i ankesës ka theksuar se e ka kuptuar pas një viti e gjysmë kur është interesuar për arsyet e mosvazhdim të gjykimit. Andaj, ka theksuar se me këtë veprim gjyqtarja është treguar joprofesionale në udhëheqjen e procedurës dhe ka treguar njëanshmëri respektivisht, paditëses ia ka mohuar realizimin e të drejtës para Gjykatave të Republikës së Kosovës si dhe ja ka humbur afatin për të parashtruar kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme.

Me datë 23.09.2022, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ankesën disiplinore të parashtruar nga K.K “SH.K” në Pejë përmes D.F.S ndaj gjyqtares M.B.

Gjyqtarja M.B në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtrueses së ankesës ka deklaruar se në lëndën civile C.nr.968/18 pasi është punuar aktvendimi, komplet lëndën e ka dorëzuar te referentët dhe tani pas verifikimi të të gjitha veprimeve del se nga pakujdesia dhe mbingarkesa nuk ju është ekspeduar palëve vendimi dhe atë jo vetëm palës paditëse por, asnjëherë nga palët ndërgjyqëse. Gjyqtarja ka theksuar se në rastin konkret nuk ka pasur as tendenca, as zvarritje apo ndonjë qëllim të shkakimit të dëmit palëve vetëm se ka rrëshqitur si gabim pa dashje duke rithesuar se gjithçka ka ndodhur pa qëllim dhe është vetëm çështje e mbingarkesës.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtares M.B, së bashku me deklaratën e saj, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar meqë, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në cilësinë e autoritetit kompetent në asnjë mënyrë dhe me asnjë provë nuk u bind se gjyqtarja M.B, me qëllim të shkakimit të ndonjë dëmi palëve ndërgjyqëse, të njejtëve nuk ju ka dërguar Aktvendimin e nxjerrë nga e njëjta.

Autoriteti kompetent ka gjetur se veprimi i tillë i gjyqtares vërehet qartë se është pasojë e pakujdesisë dhe atë jo vetëm e gjyqtares së çështjes por, edhe të zyrtares ligjore të gjyqtares që ka qenë duke punuar në atë kohë në zyrën e saj meqë, ekspedimi i vendimeve është i përfshirë në detyrat e punës së sekretares juridike/zyrtare ligjore. Për më tepër, është fakt notor se Departamenti Civil i të gjitha Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës është skajshmërisht i mbingarkuar me lëndë, të cilat konform Ligjit të Procedurës Kontestimore kërkojnë ndërmarrjen e një numri tejet të madh të veprimeve procedurale andaj, rrjedhja e gabimeve të tilla dukshëm të paqëllimshme, është i pashmangshëm.

Andaj, gabimi i tillë i cili qartazi ka rrjedhur si pasojë e pakujdesisë dhe mbingarkesës me punë, nuk mund të jenë pasojë që një gjyqtare të konsiderohet joprofesionale apo e njëanshme aq më tepër kur pretendimet e tilla nuk janë mbështetë në asnjë provë me të cilën autoriteti kompetent do të bindej se mosdorëzimi i vendimit palëve ndërgjyqëse është bërë me qëllim të caktuar dhe në keqpërdorim të detyrave zyrtare të gjyqtarit.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - AD/GJTHPE/.nr.9/22, me datë 17.10.2022

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtares M.B*
- 3. Parashtruesit të ankesës - K.K “SH.K” në Pejë*